VENDIM
Nr. 5, datë 22.2.2023

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME TIRANË SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 22.2.2023 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Sektori Juridik mbi kërkesën e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a. për licencim

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Tiranë (UK Tiranë) me shkresën nr. 1002 prot., datë 23.1.2023, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesë për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Tiranë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM- në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) shoqëria UK Tiranë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 862 009 banorë në Bashkinë Tiranë;

b) drejtues ligjor i shoqërisë është z. Elton Kacidhja.

c) drejtues teknik i shoqërisë është z. Edgar Çani i diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Elektrike, dega "Elektrikë", në vitin 1985 dhe ka mbi 5 vjet përvojë në profesion, sipas kritereve të përcaktuara në VKM nr. 958;

d) drejtues teknik i shoqërisë për impiantin është z. Enton Osmani i diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, dega "Mjedis", profili "Energjetikë" në vitin 2004 dhe ka mbi 5 vjet përvojë në profesion, sipas kritereve të përcaktuara në VKM nr. 958.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Tiranë, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Tiranë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a., me NUIS L72320033P në kategoritë:
a) kategoria A: "Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik";
b) kategoria B: "Për përpunimin e ujit për konsum publik";
c) kategoria C: "Për largimin e ujërave të ndotura".
2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
a) drejtues ligjor: Elton Kacidhja;
b) drejtues teknik: Edgar Çani;
c) drejtues teknik: Enton Osmani.
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a. është Bashkia Tiranë.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani